



Vaksina mbrojtëse nga korona në qendrën e vaksinimit - nga dhënia e terminit deri te vaksina e dytë



1. Marrëveshja e terminit

Vaksinimi në 53 qendrat e vaksinimit në Landin Nordrhein-Westfalen fillon më 8 shkurt 2021. Vaksinimi është i mundshëm vetëm me termin. Shfrytëzoni që nga 25 janari 2021 faqen e internetit për regjistrim www.116117.de. Po që se antarët e familjes tuaj e marrin për sipër regjistrimin tuaj mënjaroni patjetër terminet e dyfishta. Ju mund të shfrytëzoni edhe numrin e telefonit falas **0800 116 117 01** (Rheinland) oder **0800 116 117 02** (Westfalen). Ky numër është në dispozicion **për çdo ditë prej orës 8 deri në 22**. Për shkak të kërkesës së madhe ju duhet të llogaritni me pritje të gjata.




2. Regjistrimi në qendrat e vaksinave

Qendrat e vaksinimit nga qytetet e ndryshme janë vendosur ashtu që ato të mund të arrihen lehtë me autobus me tren dhe me veturë. Stacioni i parë atje është regjistrim: Ju lutem silleni me vete **letërnjoftimin tuaj, kartën elektronike të sigurimit shëndetësor, vërtetimin e terminit tuaj si dhe kartën e vaksinave** (nëse e keni). Ju duhet po ashtu të mbani patjetër një maskë ditore ose një maskë FFP2.




3. Sqarimi

Pastaj ju keni mundësinë gjatë pritjes tuaj që të informoheni edhe njëherë më saktësisht lidhur me vaksinimin për mbrojtjen nga korona. Nëse nuk e keni marrë me postë letrën informuese si dhe letrën lidhur me pëlqimin tuaj, atëherë ju mund ti merrni tani. Ju lutem ti lexoni me vëmendje dhe ti plotësoni. Ju mund ta keni edhe mundësinë e një bisede këshilluese me një mjek ose mjekje.




4. Vaksinimi

Vaksinimi kryhet përmes një personeli të shkolluar mjekësor dhe në një ambient të mbrojtur. Lënda e vaksinës – si te vaksinimet gripale- jipet në pjeseën e lartë të dorës. Një sasi e vogël e vaksinës është e mjaftueshme. Pastaj mbulohet pjesa e vaksionuar me një flastër. Në kartën tuaj të vaksionimit ose në vërtetimin e lëshuar shkruhen të gjitha informatat e nevojshme lidhur me vaksionimin.



5. Kontrollimi i mëtejshëm

Më tej ju luteni, që të qëndroni në një vend të pritjes dhe të jeni në vëzhtrimin e mjekut deri në 30 minuta. Kështu mund të sigurohet reagimi indaj ndonjë paraqitje shumë të rrallë alergjike ose gjendje të pakëndshme. Nëse kjo kohë kalon pa komplikime, që ndodhë zakonisht, ju mund të shkoni në shtëpi.



6. Vaksinimi i dytë

Për të arrirë mbrojtjen e plotë nga korona është i nevojshëm edhe vaksinimi i dytë. Për këtë arsye ju i merrni dy termine qysh në dhënien e terminit dy termine në një distancë kohore prej tri javësh. Edhe termini i dytë jipet në të njëjtën qënder vaksinimi dhe kryhet njësoj si në terminin e parë. Ju lutem silleni me vete letërnjoftimin, kartën elektronike të sigurimit shëndetësor, kartën e vaksinave, vërtetimin e terminit si dhe vërtetimin e vaksinimit të parë.